



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000841/3

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Rekomandohet nxjerrja e përgjegjësive dhe evidentimi i personave që kanë cënuar pasurinë në posedim të ***, si dhe shpërblimin e dëmit kësaj familjeje nga ndërhyrja e paligjshme.*

Drejtuar : **Kryeinspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit**
Z.Maringlen Qato
Pranë: Bashkisë

TIRANË

I nderuar z.Qato!

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetësja *** ka paraqitur një ankesë, në lidhje me prishjen e banesës në posedim të saj dhe anëtarëve të tjerë të familjes, në zbatimin e Projektit "Bulevardi Verior i Tiranës dhe punimet civile përkatëse" e ndodhur në zonën e Breg Lumit.

Në letër ankesë, ankuesja, shprehet se ka ndërtuar me bashkëshortin e saj, z.***, banesën në mënyrë informale dhe se për këtë banesë bashkëshorti i saj ka kryer vetëdeklarim më datë 15.03.2005, për legalizimin e saj pranë ish-ALUIZNI-t Tirana-Veri.

Për këtë çështje, është kërkuar informacion dhe shpjegime si IMT-së pranë, Bashkisë Tiranë, ashtu dhe ish-ALUIZNI-t Tirana-Veri apo Bashkisë Tiranë.

Ju z.Kryeinspektor, informoni, se, me shkresat nr.13019 prot, datë 03.04.2018, dhe nr.15606, datë 10.04.2019, keni kërkuar ish-ALUIZNI-t Tirana-Veri, përjashtimin nga legalizimi të ndërtimeve informale, të cilat preken nga realizimi i Projektit "Bulevardi Verior i Tiranës dhe punimet civile përkatëse", pjesë e të cilave është dhe banesa e ankueses.

Në përgjigje të kërkesës për dhënie informacioni dhe shpjegimesh, ish-ALUIZNI Tirana-Veri, informon se, me shkresën nr.8579, datë 24.08.2018, ka njoftuar IMT-në

pranë Bashkisë Tiranë, për nxjerrjen e Vendimit 16266, datë 20.09.2018, sipas të cilit është vendosur për përjashtimin nga legalizimi të ndërtimit informal të vetëdeklaruar prej z.***.

Në këto kushte, IMT-ja pranë Bashkisë Tiranë, ka vijuar kryerjen e veprimeve duke nxjerrë aktet administrative nr.458, datë 05.12.2018, “Përprishjen e objektit të kundërligjshëm” si dhe nr.1330, datë 05.12.2018, “Për dënimin me gjobë”, në ngarkim të z.***. Këto vendime, ju shpreheni, se i keni dërguar subjektit me shkresën nr.46767, datë 19.12.2018. Pas dërgimit të akteve administrative të lartpërmendur, shpreheni se keni kërkuar Njësisë Administrative nr.8, Tiranë, afishimin e vendimeve të lartpërmendura. Për dërgimin zyrtar të vendimeve të lartpërmendura ju nuk keni vënë në dispozicion të Institucionit tone të ndonjë akti, shkrese, etj, e cila do të vërtetonte dërgimin etyre pranë vendbanimit të ankueses. Në këto kushte i jeni drejtuar Njësisë Administrative nr.8, Tiranë, për afishimin e këtyre vendimeve.

Njoftimi publik i vetëdeklaruesit, z.***, bashkëshort i ankueses, nuk mund të vlerësohet i kryer në përputhje me parashikimet e nenit 162 të Kodit të Procedurës Administrative. Në dispozitën ligjore të përmendur, parashikohet, se:

“Njoftimi publik

1. Njoftimi publik bëhet në këto raste:

a)kur palët janë të panjohura;

b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi;

c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur;

ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji.

2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet.

3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara. Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

4. Përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetatat me tirazh më të madh.

5. Në rastin e njoftimit të një akti administrativ, teksti i shpallur përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 99, të këtij Kodi, me përjashtim të pjesës arsyetuese. Ai shoqërohet me të dhëna për zyrën, vendin dhe mënyrën e njohjes me përmbajtjen e plotë të aktit administrative”.

Referuar parashikimit të kësaj dispozite ligjore, IMT-ja pranë Bashkisë Tiranë, nuk mund të kryente njoftimin e akteve përkatëse administrative ankuesit, në kushtet e parashikuara nga nenin 162 të K.Pr.A., për shkak se, nuk jemi në asnjë nga rrethanat e parashikuara nga ky nen. Pra, së pari, duhet të provohet se njoftimi ishte i pamundur të kryhej e më pas duhet të procedoj në këtë mënyrë.

Kjo procedurë e ndjekur nga IMT-ja pranë Bashkisë Tiranë, nuk plotëson qëllimin për të cilin është parashikuar në ligj dhe për më tepër nuk provohet as vendosja e këtij njoftimi në faqen e internetit të tij siç kërkohet nga neni 162, pika 4, për arsye se, nuk është kryer njoftimi i aktit administrativ në rrethanat e parashikuara nga dispozita ligjore e sipërcituar. Zhvillimi i kësaj veprimtari në këtë mënyrë ka sjell pasoja të rënda për ankuesen dhe familjarët e saj.

Në këtë situatë ligjor të çështjes, inspektorët e IMT-së pranë Bashkisë Tiranë, më datë 09.04.2019, kanë shkuar pranë banesës së ankueses duke e prishur atë.

Në këto rrethana, barra e provës për njoftimin e Vendimit nr.458, datë 05.12.2018, *“Përprishjen e objektit të kundërligjshëm”* si dhe nr.1330, datë 05.12.2018, *“Për dënimin me gjobë”*, bie mbi organin e IMT-së pranë Bashkisë Tiranë.

Nga shpjegimet e dhëna me shkrim dhe kopja e dokumentacionit të dërguar mbi këtë problematikë prej IMT-së, pranë Bashkisë Tiranë, rezulton se, ky organ nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore.

Tjetër problem i evidentuar në këtë rast, është se momenti i njoftimit barazohet me momentin e ekzekutimit të një vendimi për prishje objekti. Kjo mënyrë procedimi nuk vjen në përputhje me konceptin e hyrjes në fuqi dhe i sjelljes së pasojave të aktit administrative. Njoftimi i aktit dhe lënia e afatit ligjor reflekton mundësinë kohore të subjektit me njohjen e përmbajtjes së këtij akti dhe reagimin fillestar për ndjekjen e rrugës së ankimit administrativ apo gjyqësor, ndaj tij.

Kjo mënyrë trajtimi, e cila realisht flet për mungesë veprimi nga ana e IMT-së pranë Bashkisë Tiranë, konstaton faktin tjetër, se, ankueses i është përkeqësuar situata konkrete ligjore duke ju shkelur një e drejtë themelore në këtë proces, që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është afirmuar si, e drejta për një proces të rregullt ligjor. Edhe përcaktimi i dhënë në paragrafin e parë, të nenit 14, të ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, i ndryshuar, ku thuhet se:

“Kundër vendimit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore lejohet ankimi i drejtëpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit”,

shkon në të njëjtën llogjikë me respektimin e së drejtës së ankuesit për një proces të rregullt ligjor.

Fryma dhe logjika e ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, i ndryshuar, në përcaktimin e kompetencave dhe afateve proceduriale, për konstatimin e ndërtimit të kundërligjshëm, nxjerrjen e vendimit përkatës penalizues për kundërvajtësin, njoftimin e këtij vendimi dhe

ekzekutimin e tij, është e tillë që shkon në të njëjtën linjë përputhshmërie me respektimin e së drejtës themelore të individit, për një proces të rregullt ligjor në rrafshin administrativ të shqyrtimit të çështjes.

Në këtë çështje vërehet se, IMT-së pranë Bashkisë Tiranë, nuk arrin të vërtetojë ezaurimin e procedurës së njoftimit zyrtar, të dy akteve në fjalë të nxjerra në ngarkim të ***, bashkëshorti i ankueses.

Ky është rasti kur, kemi të bëjmë me një ndërtim të kundërligjshëm të cilësuar si të tillë nga vendimmarrja paraprake e ALUIZNI-t, dihet identiteti i subjektit kundërvajtës, njihet adresa e saktë e kundërvajtësit, por gjatë ushtrimit të kompetencave ligjore nga ana e IMT-së pranë Bashkisë Tiranë, për konstatimin, sanksionimin me vendimmarrjen përkatëse të ndërtimit të kundërligjshëm dhe njoftimit të akteve të dala subjektit kundërvajtës, për të vazhduar me ekzekutimin e vendimmarrjes respektive, ka dështuar faza e njoftimit efektiv zyrtar të akti administrativ.

Ekzekutimi i vendimit të marrë në këtë rast do të duhej të kryhej në përputhje dhe respektim të të gjitha afateve ligjore të njoftimit, të parashikuara sipas specifikës së çështjes në nenet 147-163, të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje është me vend të sjellim në vëmendjen tuaj, parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuara në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht, se: *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi”*. Mosveprimi i IMT-së pranë Bashkisë Tiranë, në kushtet e parashikuara nga ligji nr.8510 datë 15.07.1999 *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”*, i ndryshuar, pasi realisht i është shkaktuar dëm ankueses, në kushtet e trajtimit jo në përputhje me parashikimet ligjore të kësaj çështjeje.

Në kuptimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore, si një detyrim i organeve të administratës shtetërore (ku bëni pjesë edhe ju), për të shpërblyer dëmin që i është shkaktuar interesave të ankueses dhe familjarëve të saj si person privat, në ushtrim e sipër të funksioneve tuaja publike, rasti në fjalë parashikohet në nenin 3/a, të ligjit nr.8510 datë 15.07.1999, *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”*, i ndryshuar, ku thuhet se:

“Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë private, në rastet që vijnë:

Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme”.

Mbi këtë bazë dhe në përputhje me parashikimet e bëra në nenet 5 dhe 8, të ligjit të lartpërmendur, ju tashmë duhet që të filloni një procedim administrativ për njohjen e dëmit që i keni shkaktuar *** në këtë rast, duke marrë për bazë edhe dispozitat respektive të Kodit Civil, për shkaktimin e dëmit.

Në këtë këndvështrim, duam t’ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti European, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit:

“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”.

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në përputhje me nenin 18, Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar, ku thuhet përkatësisht, shprehimisht se:

*“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,
“Procedurat për kërkimin dhe përmbushjen e dëmshpërblimit bëhen në përputhje me kërkesat e ligjit 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,*

REKOMANDOJMË

*“Nxjerrjen e përgjegjësive dhe evidentimin e personave që kanë cënuar pasurinë në posedim të ***”.*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454, datë 4.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA(CANAJ)